



SHOQATA
KOMBËTARE
E BASHKIVË
TË SHQIPËRISË



RCDN
Regional Capacity
Development Network
for Water and
Sanitation Services

ZHVILLIMI I STRATEGJISË SË Mbledhjes së Fondeve dhe Modelit të ri të Anëtarësimit Për SHKBSH



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



Zhvillimi i Strategjisë së Mbledhjes së Fondeve dhe Modelit të Ri të Anëtarësimit për SHKBSH

Qëndrueshmëria financiare dhe kapaciteti institucional i organizatave përfaqësuese të pushtetit vendor përbëjnë një dimension thelbësor në procesin e forcimit të decentralizimit dhe konsolidimit të qeverisjes vendore në Shqipëri. Kjo çështje merr rëndësi të veçantë në kontekstin aktual, ku vendi pritet të ndërmarrë një reformë të re administrativo-territoriale, e cila synon riorganizimin e pushtetit vendor dhe rritjen e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike, duke krijuar njëkohësisht një realitet të ri institucional dhe financiar për aktorët e përfshirë.

Në këtë perspektivë, mobilizimi i burimeve financiare nuk duhet trajtuar thjesht si një funksion teknik dhe administrativ, por si një komponent strategjik i zhvillimit organizativ. Ai ndikon drejtpërdrejt në autonominë institucionale, efektivitetin operacional dhe kapacitetin përfaqësues të organizatave të pushtetit vendor. Në të njëjtën kohë, ky proces është i ndërlidhur me funksionet e tjera thelbësore organizative dhe pasqyron nivelin e zhvillimit institucional, cilësinë e shërbimeve të ofruara, si dhe shkallën e besueshmërisë që organizata gëzon ndërmjet anëtarëve dhe partnerëve të saj institucionalë.



Implemented by:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Tabla Permbledhese

Hyrja	3
2. Qëllimi dhe Objektivat	3
2.1. Qëllimi i Studimit	3
2.2. Objektivat e Studimit	3
3. Metodologjia	4
4. Analiza e Kontekstit	4
4.1 Rëndësia e SHKB-së dhe roli në qeverisjen vendore	4
4.2 Performanca e mbledhjes së kuotave të anëtarësimit	4
4.3. Parashikimi financiar (2026–2030)	5
5. Analiza mbi perceptimin e bashkive dhe potencialin financiar	6
5.1 Struktura e kampionit	6
5.2 Perceptimi ndaj SHKB-së	7
5.3. Ndikimi në zhvillimin vendor	7
5.4. Shërbimet e përdorura dhe gatishmëria e bashkive	7
6. Analiza e intervistave dhe përpunimi i të dhënave	8
6.1 Roli i SHKB-së	8
6.2 Prioritetet kryesore	8
7. Modeli i ri i anëtarësimit	9
7.1 Struktura e anëtarësimit dhe kuotat	9
7.2 Mekanizmat e angazhimit të anëtarësisë	9
8. Hartimi i strategjisë së mbledhjes së fondeve	10
8.1. Objektivat strategjike	10
8.2. Instrumentet dhe burimet e financimit	11
1. Kuotat e anëtarësimit	11
2. Mbështetja qeveritare dhe institucionale (shih kapitullin 9)	11
3. Projektet dhe fondet nga donatorët	11
4. Shërbimet me Pagesë	12
5. Partneritetet	12
9. Mbështetja qeveritare për organizatat europiane dhe reforma për Shqipërinë	12
9.1 Modelet e mbështetjes qeveritare në Evropë	13
9.2 Kuadri aktual në Shqipëri dhe propozimi për reformim	14
9.3 Drejtimet e politikës dhe vlerësimi krahasues	14
10. Konkluzione dhe Rekomandime	15
10.1 Konkluzione	15
10.2 Rekomandime strategjike dhe masa të zbatimit	16
11. Aneks	18
11.1. Pyetësori për Bashkitë: Strategjia e mbledhjes së fondeve dhe Modeli i Ri i anëtarësimit	18
11.2. Intervistat për modelin e ri dhe strategjinë e fondeve	21
Seksioni 1: Roli dhe përfaqësimi institucional	21
Seksioni 2: Vlerësimi i shërbimeve	21
Seksioni 3: Shërbimet me pagesë dhe modeli financiar	21
Seksioni 4: Modeli i anëtarësimit	21
12. Referencat	22

Hyrja

Në kushtet e zhvillimeve të vazhdueshme të qeverisjes vendore dhe rritjes së kërkesave për ofrimin e shërbimeve më cilësore ndaj qytetarëve, organizatat që përfaqësojnë interesat e bashkive përballen me nevojën për të forcuar kapacitetet e tyre institucionale dhe financiare. Në këtë kontekst, Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e bashkive, duke ofruar shërbime, përfaqësim dhe koordinim në nivel kombëtar.

Megjithatë, për të përmbushur në mënyrë efektive këtë rol, bëhet i domosdoshëm sigurimi i një baze të qëndrueshme financiare dhe zhvillimi i mekanizmave më efikas të financimit. Modelet tradicionale të financimit shpesh rezultojnë të kufizuara dhe të varura nga burime të paqëndrueshme, duke e bërë të nevojshëm rishikimin e tyre në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë dhe autonomisë financiare të organizatës.

Në këtë kuadër, ky studim synon të analizojë situatën aktuale të SHKB-së, të identifikojë sfidat kryesore dhe të propozojë zgjidhje konkrete për përmirësimin e modelit të anëtarësimit dhe zhvillimin e një strategjie të qëndrueshme të mbledhjes së fondeve. Analiza mbështetet në një kombinim të metodave sasiore dhe cilësore, duke përfshirë të dhëna empirike, intervista dhe perceptimet e anëtarëve. Kjo qasje plotësohet me praktikatat më të mira ndërkombëtare, përfshirë përvojat e vendeve të OECD në financimin dhe funksionimin e shoqatave të pushtetit vendor.

2. Qëllimi dhe Objektivat

2.1. Qëllimi i Studimit

Qëllimi i këtij studimi është zhvillimi i një strategjie të qëndrueshme dhe të integruar për mbledhjen e fondeve, si dhe hartimi i një modeli të ri anëtarësimi për Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, të bazuar në nevojat reale dhe kapacitetet financiare të bashkive anëtare, si dhe në praktikatat më të mira ndërkombëtare. Në këtë kuadër, studimi synon të evidentojë problematikat dhe të sugjerojë përmirësime në strukturën e financimit të organizatës, të rrisë diversifikimin e burimeve të të ardhurave dhe të forcojë lidhjen ndërmjet kontributit të anëtarëve dhe përfitimeve që ata marrin.

2.2. Objektivat e Studimit

Për arritjen e këtij qëllimi, studimi synon të përmbushë këto objektiva specifike:

- Të analizojë situatën aktuale financiare dhe burimet ekzistuese të të ardhurave të SHKB-së
- Të vlerësojë nivelin e angazhimit dhe kontributit financiar të bashkive anëtare
- Të identifikojë burime alternative dhe të qëndrueshme financimi
- Të analizojë perceptimet dhe nevojat e anëtarëve në lidhje me shërbimet e ofruara
- Të propozojë një model të ri anëtarësimi të drejtë dhe të diferencuar
- Të hartojë një strategji të integruar për mbledhjen e fondeve

3. Metodologjia

Metodologjia e këtij studimi përfshin një kombinim të metodave sasore dhe cilësore për të siguruar një analizë të thelluar dhe të vlefshme në funksion të objektivave të përcaktuara. Në aspektin empirik, studimi mbështetet në të dhëna të mbledhura nga bashkitë anëtare, si dhe në analiza dhe raporte krahasuese me praktikatat ndërkombëtare. Përdorimi i metodave të kombinuara kontribuon në kuptimin e perceptimeve, nevojave dhe pritshmërive të anëtarëve në lidhje me shërbimet dhe modelin e anëtarësimit. Qasja e kombinuar krijon një bazë të qëndrueshme dhe të argumentuar për zhvillimin e strategjisë financiare të SHKB-së për periudhën 2026–2030. Në funksion të studimit, është hartuar një pyetësor për drejtues dhe specialistë të 61 bashkive, me synim sigurimin e një baze të gjerë dhe përfaqësuese të të dhënave. Gjithashtu do të integrohen intervista gjysmë të strukturuar për të siguruar një panoramë dhe perceptim sa më të qartë të funksionarëve vendorë mbi objektin e studimit.

4. Analiza e Kontekstit

4.1 Rëndësia e SHKB-së dhe roli në qeverisjen vendore

Shoqata Kombëtare e Bashkive përbën një aktor kyç në zhvillimin dhe konsolidimin e qeverisjes vendore në Shqipëri. Roli i saj është shumëdimensional dhe përfshin funksione përfaqësuese, ofrimin e shërbimeve profesionale, si dhe advokimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në funksionin e saj përfaqësues, SHKB vepron si zëri institucional i bashkive anëtare në dialogun me qeverinë qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë, duke kontribuar në proceset vendimmarrëse dhe në mbrojtjen e interesave të pushtetit vendor. Paralelisht, organizata ofron një gamë shërbimesh profesionale, përfshirë trajnime, asistencë teknike dhe produkte analitike, të cilat mbështesin forcimin e kapaciteteve institucionale të bashkive.

Nëpërmjet rolit të saj advokues, SHKB ndërmjetëson midis nevojave të bashkive dhe politikave publike, duke lehtësuar aksesin në mundësi zhvillimi, projekte dhe burime financiare. Në këtë kuadër, SHKB nuk funksionon thjesht si një strukturë administrative, por si një platformë strategjike që kontribuon në fuqizimin dhe modernizimin e qeverisjes vendore.

4.2 Performanca e mbledhjes së kuotave të anëtarësimit

Performanca e mbledhjes së kuotave të anëtarësimit përbën një tregues kyç të kapacitetit financiar, qëndrueshmërisë institucionale dhe nivelit të besimit që bashkitë anëtare kanë ndaj SHKB-së. Analiza e të dhënave për periudhën 2021–2025 evidenton një trend të qëndrueshëm rritës në nivelin e arkëtimit, duke reflektuar një përmirësim gradual të angazhimit financiar të anëtarëve dhe të rolit të organizatës në sistemin e qeverisjes vendore.

Rritja progresive e nivelit të arkëtimit, nga 38.5% në vitin 2021 në 74.5% në vitin 2025, tregon një konsolidim të marrëdhënies ndërmjet SHKB-së dhe bashkive anëtare, si dhe një perceptim në rritje të vlerës së shërbimeve dhe funksionit përfaqësues të organizatës. Ky zhvillim lidhet ngushtë me përmirësimin e kapaciteteve institucionale të SHKB-së, rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe intensifikimin e rolit të saj në proceset e advokimit dhe ndërmjetësimit institucional.

Ecuria e arkëtimeve gjatë pesë viteve të fundit (grafik nr.1)

2021 (38.5%) – Niveli i ulët i arkëtimit reflekton ndikimin e pasojave financiare të periudhës pas pandemisë COVID-19, si dhe orientimin e bashkive drejt përballimit të prioriteteve emergjente. Ky vit shënon një fazë tranzitore dhe një pikënisje për rikuperim.

2022 (49.7%) – Evidentohet një rritje e ndjeshme, e lidhur me stabilizimin gradual të situatës financiare dhe rikthimin e fokusit në detyrimet institucionale ndaj organizatës.

2023 (55.3%) – Trendi pozitiv vijon në mënyrë të qëndrueshme, i ndikuar nga përmirësimi i shërbimeve dhe asistencës së ofruar nga SHKB.

2024 (67.6%) – Shënohet një progres i konsiderueshëm, që reflekton rritjen e besimit të anëtarëve dhe forcimin e rolit përfaqësues të organizatës.

2025 (74.5%) – Arrihet niveli më i lartë historik i arkëtimit, duke treguar një konsolidim të dukshëm të kapaciteteve financiare dhe të profesionalizmit institucional të SHKB.


4.3. Parashikimi financiar (2026–2030)

Parashikimet për periudhën 2026–2030 tregojnë një rritje graduale të nivelit të arkëtimit të kuotave të anëtarësimit, e mbështetur në forcimin e asistencës institucionale, rritjen e transparencës dhe zbatimin e modelit të ri të anëtarësimit. Konkretisht, niveli i arkëtimit pritet të arrijë në rreth 78–80% në vitin 2026, trend që pritet të forcohet për të arritur mbi 95% në vitin 2030.

Ky trend rritës reflekton përmirësimin e kapaciteteve institucionale të SHKB-së, konsolidimin e mekanizmave të komunikimit financiar dhe forcimin e lidhjes ndërmjet kontributit financiar dhe vlerës së perceptuar të shërbimeve të ofruara.

Megjithatë, realizimi i këtyre parashikimeve mund të kushtëzohet nga disa risqe, si ndryshimet në kontekstin makroekonomik, kufizimet në kapacitetet financiare të bashkive, apo efektet e mundshme të reformës së re administrativo-territoriale mbi strukturën dhe burimet e tyre financiare. Për rrjedhojë, strategjia duhet të jetë e adaptueshme ndaj këtyre zhvillimeve, duke pasur në konsideratë zbatimin e modelit të ri të anëtarësimit, diversifikimin e vazhdueshëm të paketës së shërbimeve dhe ruajtjen e komunikimit të qëndrueshëm dhe proaktiv me bashkitë anëtare.

Grafik 1. Niveli i arkëtimit të kuotave (2021–2025) dhe parashikimet (2026–2030)



5. Analiza mbi perceptimin e bashkive dhe potencialin financiar

Për realizimin e analizës empirike mbi perceptimet e bashkive anëtare, gatishmërinë për kontribut financiar dhe potencialin ekonomik, është përdorur një pyetësor i standardizuar, i administruar tek 165 përfaqësues të bashkive. Ky kampion siguron një bazë të gjerë dhe përfaqësuese për analizë sasiore.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar duke përdorur tregues statistikore përmbledhës, me qëllim identifikimin e tendencave kryesore dhe krahasimin e rezultateve sipas karakteristikave të bashkive. Analiza fokusohet në vlerësimin e perceptimit ndaj rolit të SHKB-së, ndikimit të shërbimeve në zhvillimin vendor, si dhe në identifikimin e kërkesës për shërbime me pagesë dhe nivelit të gatishmërisë për kontribut financiar.

Në këtë kuadër, rezultatet empirike shërbejnë si bazë analitike për ndërtimin e modelit të ri të anëtarësimit dhe për përcaktimin e elementeve kryesore të strategjisë së mbledhjes së fondeve.

5.1 Struktura e kampionit


Struktura e kampionit tregon se pjesa më e madhe e bashkive të përfshira janë të vogla dhe të mesme, me 48% që i përkasin kategorisë 10,001–50,000 banorë dhe 26% kategorisë 50,001–100,000 banorë. Bashkitë shumë të mëdha (mbi 250,000 banorë) përfaqësojnë vetëm 3% të kampionit, duke reflektuar një përqendrim të analizës në njësitë vendore me kapacitete më të kufizuara administrative dhe financiare.

Interpretim:

Dominimi i bashkive të vogla dhe të mesme


reflekton strukturën reale të pushtetit vendor dhe

thekson nevojën për një model financiar të diferencuar.




5.2 Perceptimi ndaj SHKB-së

Vlerësimet e bashkive tregojnë perceptim kryesisht pozitiv ndaj SHKB-së. 92% e bashkive e vlerësojnë rolin të dobishëm, çka dëshmon për një nivel të lartë legjitimiteti institucional dhe besimi ndaj organizatës. Ky rezultat përbën një bazë të fortë për zhvillimin dhe zbatimin e modelit të ri të anëtarësimit, duke sugjeruar se ekziston një predispozitë e favorshme për rritjen e angazhimit dhe kontributit financiar nga ana e anëtarëve.



5.3. Ndikimi në zhvillimin vendor

89% e tyre e vlerësojnë të lartë ndikimin e shoqatës në zhvillimin vendor. Analiza eidenton gjithashtu një lidhje të fortë ndërmjet përdorimit të shërbimeve dhe perceptimit të ndikimit, ku bashkitë që përfitojnë më shumë nga shërbimet e ofruara prirën të raportojnë nivele më të larta vlerësimi.




5.4. Shërbimet e përdorura dhe gatishmëria e bashkive

Analiza e të dhënave eidenton se trajnimet përbëjnë shërbimin më të përdorur nga bashkitë anëtare. 71% të tyre raportojnë përdorimin e këtij shërbimi, duke përbërë një element kyç të vlerës së ofruar për anëtarët. Pas trajnimeve rendite asistencë teknike, ndjekur nga konsulenca ligjore, produktet analitike dhe eventet.

Sa i përket cilësisë së shërbimeve të ofruara nga SHKB, 91% shprehin vlerësim pozitiv.



Anketa tregon një kërkesë eë lartë për shërbime të posacme me pagesë. Trajnimet e specializuara paraqiten si shërbimi më i kërkuar (66%), ndjekur nga asistenca individuale dhe konsulenca ligjore dhe produktet analitike. 54% e bashkive shfaqin një gatishmëri reale për pagesë, çka tregon ekzistencën e një potenciali të konsiderueshëm për zhvillimin e shërbimeve me pagesë. Analiza eidenton ekzistencën e një baze reale tregu për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve me pagesë, bashkitë e mëdha paraqesin nivelin më të lartë të gatishmërisë për pagesë (78%).



6. Analiza e intervistave dhe përpunimi i të dhënave

Për të plotësuar analizën sasiore dhe për të mundësuar një kuptim më të thelluar të perceptimeve dhe qëndrimeve të bashkive anëtare, u realizuan intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues në nivel drejtues. Këto intervista shërbyen për mbledhjen e të dhënave cilësore lidhur me rolin e SHKB-së, identifikimin e nevojave prioritare dhe eidentimin e sfidave kryesore në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe sigurimit të burimeve financiare.

Të dhënat e mbledhura u përpunuan përmes analizës tematike, duke mundësuar identifikimin e modeleve të përsëritura, qëndrimeve të përbashkëta dhe variacioneve ndërmjet bashkive, veçanërisht në funksion të madhësisë dhe kapaciteteve të tyre institucionale. Ky proces kontribui në forcimin e vlefshmërisë së gjetjeve dhe në ndërtimin e një baze analitike më të qëndrueshme për formulimin e rekomandimeve strategjike.

6.1 Roli i SHKB-së

Rezultatet e analizës së intervistave eidentojnë se SHKB perceptohet gjerësisht si një aktor kyç në përfaqësimin e interesave të pushtetit vendor në nivel kombëtar. Bashkitë anëtare theksojnë veçanërisht kontributin e saj në advokimin për politika publike në favor të pushtetit vendor, në ndërmjetësimin me institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe në krijimin e platformave për bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash.

Në mënyrë të veçantë, vihet re se bashkitë me një nivel më të lartë ndërveprimi me SHKB priren ta vlerësojnë më pozitivisht rolin e saj, duke e konsideruar atë si një partner strategjik në mbështetje të zhvillimit institucional dhe përfaqësimit të interesave të tyre.

6.2 Prioritetet kryesore

Gjetjet nga intervistat nxjerrin në pah një sërë prioritetesh të bashkive anëtare, të cilat lidhen ngushtë me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e performancës në funksionet kyçe të qeverisjes vendore. Në mënyrë të veçantë, theksohet nevoja për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të specializuara, ofrimin e asistencës teknike të personalizuar në fusha të tilla si financat vendore, planifikimi dhe menaxhimi i projekteve, si dhe mbështetjen ligjore në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, kërkohet

akses më i gjerë në produkte analitike dhe modele praktike që mund të lehtësojnë proceset vendimmarrëse dhe administrative. Analiza nxjerr në pah diferencime të qarta ndërmjet kategorive të bashkive. Bashkitë e vogla evidentojnë më së shumti nevojën për mbështetje bazë dhe asistencë të drejtpërdrejtë operacionale, ndërsa bashkitë e mëdha shfaqin kërkesë më të lartë për shërbime të specializuara, veçanërisht në kontekstin e proceseve të integritetit evropian.

7. Modeli i ri i anëtarësimit

Gjetjet evidentojnë se bashkitë anëtare të SHKB-së karakterizohen nga nivele të ndryshme të kapaciteteve financiare, pritshmërive dhe gatishmërisë për kontribut. Në këtë kontekst, lind nevoja për një model anëtarësimi të diferencuar, fleksibël dhe të orientuar drejt vlerës së ofruar, i cili të reflektojë heterogjenitetin e anëtarësisë.

Modeli i ri synon ndërtimin e një sistemi efikas, transparent dhe të qëndrueshëm financiarisht, në të cilin kontributi i çdo bashkie të jetë në përputhje me kapacitetin e saj financiar dhe me nivelin e përfitimeve nga shërbimet e ofruara. Ky model synon gjithashtu të forcojë lidhjen ndërmjet angazhimit financiar dhe vlerës së shtuar institucionale, duke rritur kështu motivimin për pjesëmarrje aktive dhe përmbushje të detyrimeve nga ana e anëtarëve.

7.1 Struktura e anëtarësimit dhe kuotat

Modeli i propozuar i anëtarësimit parashikon kategorizimin e bashkive në grupe të diferencuara, bazuar kryesisht në madhësinë e popullsisë dhe, në një fazë të mëvonshme, në kapacitetet e tyre financiare. Në këtë kuadër, identifikohen tre kategori kryesore: bashki të mëdha, bashki të mesme dhe bashki të vogla.

Gjetjet empirike tregojnë se gatishmëria për pagesë rritet në mënyrë të ndjeshme në rastet kur bashkitë perceptojnë përfitime konkrete dhe të matshme nga anëtarësimi, çka nënvizon rëndësinë e ndërtimit të një modeli që lidh qartë kontributin financiar me vlerën e përfituar. Në këtë kuadër, shërbimet kryesore përfshijnë trajnime dhe programe të zhvillimit profesional, asistencë teknike dhe këshillim të specializuar, produkte analitike dhe studime, përfaqësim institucional dhe advokim, si dhe akses në projekte dhe partneritete strategjike. Kjo qasje mundëson krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet kontributit financiar dhe përfitimit të marrë, duke rritur transparencën, angazhimin dhe gatishmërinë për pagesë nga ana e anëtarëve, si dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë financiare të organizatës.

7.2 Mekanizmat e angazhimit të anëtarësisë

Modeli i ri i anëtarësimit mbështetet në një sërë parimesh themelore, të cilat synojnë të garantojnë funksionalitetin, drejtësinë dhe qëndrueshmërinë e tij në afatgjatë. Në këtë kuadër, modeli parashikon një sërë mekanizmash:

1- Rekomandohet aplikimi i stimujve jofinanciarë, si dhënia e certifikatave dhe vlerësimeve për kontributin institucional, përfshirja në forume strategjike dhe evidentimi i praktikave më të mira, të cilat kontribuojnë në rritjen e motivimit dhe njohjes institucionale.

2- Forcimi i komunikimit dhe mekanizmeve të feedback-ut përmes buletineve periodike informuese, platformave online për shkëmbim informacioni dhe organizimit të takimeve të rregullta me anëtarët, mundëson një ndërveprim më të strukturuar dhe transparent.

3- Integrimi më i thelluar i bashkive në proceset e qeverisjes së organizatës, përmes përfshirjes aktive në vendimmarrje dhe krijimit të mekanizmeve të konsultimit për politikën dhe shërbimet, kontribuon në rritjen e ndjenjës së pronësisë dhe përgjegjësisë institucionale. Në tërësi, këto mekanizma synojnë të rrisin vlerën e perceptuar të anëtarësimit dhe të forcojnë lidhjen afatgjatë ndërmjet bashkive dhe SHKB-së.

8. Hartimi i strategjisë së mbledhjes së fondeve

Në një kontekst ku organizatat e pushtetit vendor përballen me kufizime strukturore në aksesin ndaj burimeve të qëndrueshme financiare, diversifikimi i burimeve të të ardhurave paraqitet si një domosdoshmëri strategjike dhe jo thjesht si një zgjedhje operationale.

Qasja e propozuar mbështetet në një arkitekturë financiare me burime të ndryshme, e cila synon reduktimin e varësisë nga financimet e paqëndrueshme, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, dhe njëkohësisht rritjen e autonomisë institucionale. Në këtë kuadër, burimet e financimit nuk trajtohen si instrumente të izoluar, por si komponentë të një sistemi të integruar, ku ndërveprimi ndërmjet tyre gjeneron stabilitet financiar dhe kapacitete të zgjeruara operationale.

Në mënyrë të veçantë:

- Kuotat e anëtarësimit sigurojnë stabilitet dhe parashikueshmëri;
- Mbështetja qeveritare dhe institucionale kontribuon në legjitimitetin dhe funksionin publik të organizatës;
- Financimi nga donatorët mbështet inovacionin dhe zhvillimin institucional;
- Shërbimet me pagesë dhe partneritetet rrisin vetëfinancimin dhe fleksibilitetin;
- Iniciativat e Përgjegjësisë Sociale Korporative (CSR) krijojnë sinergji ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

8.1 Objektivat strategjike

Strategjia e financimit artikullohet rreth një grupi objektivash strategjike të ndërlidhur, të cilët synojnë transformimin e modelit financiar të organizatës nga një model reaktiv në një model proaktiv dhe të qëndrueshëm. Objektivat kryesorë përfshijnë:

- **Diversifikimin e burimeve të të ardhurave**, përmes zgjerimit të portofolit financiar dhe reduktimit të varësisë nga burime të vetme ose të paqëndrueshme;
- **Rritjen e qëndrueshmërisë financiare**, duke siguruar rrjedha të qëndrueshme dhe të parashikueshme të të ardhurave;
- **Optimizimin e sistemit të kuotave të anëtarësimit**, përmes përmirësimit të mekanizmeve të mbledhjes dhe rritjes së normës së kontributit;
- **Forcimin e lidhjes ndërmjet vlerës së shërbimeve dhe kontributit financiar**, duke rritur perceptimin e vlerës nga anëtarët;

- **Rritjen e pavarësisë institucionale**, përmes zgjerimit të burimeve të vetëgjeneruara dhe reduktimit të varësisë nga financimet e jashtme;
- **Rritjen e kapaciteteve për mobilizimin e burimeve financiare**, duke përfshirë zhvillimin e kompetencave në fundraising, menaxhim projektesh dhe partneritete strategjike.

Këto objektiva përbëjnë bazën për zhvillimin e një modeli financiar të qëndrueshëm, i cili mbështet realizimin efektiv të misionit të organizatës.

8.2. Instrumentet dhe burimet e financimit

1. Kuotat e anëtarësimit

Kuotat e anëtarësimit përbëjnë burimin themelor dhe më të qëndrueshëm të të ardhurave për SHKB. Në përputhje me modelin e ri të anëtarësimit, ato do të strukturohen mbi bazën e një sistemi të diferencuar, i cili reflekton madhësinë dhe kapacitetet financiare të bashkive anëtare.

2. Mbështetja qeveritare dhe institucionale (shih kapitullin 9)

Mbështetja nga institucionet publike përbën një komponent të rëndësishëm, por aktualisht të nën-zhvilluar, të financimit të organizatës. Në kushtet aktuale, kjo mbështetje realizohet kryesisht në mënyrë indirekte, përmes përfshirjes në programe publike, asistencës teknike dhe bashkëfinancimeve.

Megjithatë, analiza krahasuese me modelet europiane evidencon se institucionalizimi i mekanizmave të financimit të drejtpërdrejtë për organizatat përfaqësuese të pushtetit vendor përbën një praktikë të konsoliduar, e cila kontribuon në:

- Rritjen e efektivitetit në politikëbërje;
- Përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional;
- Forcimin e kapaciteteve të përfaqësimit.

3. Projektet dhe fondet nga donatorët

Financimi nga donatorët përfaqëson një burim të rëndësishëm për mbështetjen e reformave dhe zhvillimit institucional, por karakterizohet nga një shkallë e kufizuar qëndrueshmërie. Për këtë arsye, është e domosdoshme rritja e kapaciteteve për identifikimin e mundësive të financimit, përgatitjen e aplikimeve konkurruese dhe menaxhimin efektiv të projekteve.

Orientimi strategjik i këtij burimi duhet të përqendrohet në mbështetjen e prioriteteve të Planit Strategjik të SHKB-së, në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në zhvillimin e shërbimeve që adresojnë nevojat specifike të anëtarëve.

4. Shërbimet me Pagesë

Zhvillimi i shërbimeve me pagesë përfaqëson një instrument të rëndësishëm për rritjen e vetë-financimit dhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave. Në këtë kuadër, një rol të veçantë zënë programet e zhvillimit profesional, të strukturuar mbi modele të akredituara dhe të bazuara në sistemin e krediteve.

Këto programe synojnë të kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës vendore, duke krijuar njëkohësisht një mekanizëm të qëndrueshëm gjenerimi të të ardhurave për organizatën.

5. Partneritetet

SHKB e ka një ndër objektivat e saj organizimin e aktiviteteve dhe përfshirjen e komunitetit në proceset me karakter edukativ, social-kulturor dhe sportiv. Partneritetet ndërinstitucionale përbëjnë një dimension të rëndësishëm të strategjisë së financimit. Bashkëpunimi me sektorin privat, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet akademike kontribuon në rritjen e kapaciteteve dhe në zgjerimin e ndikimit të SHKB-së.

Në këtë kuadër, sponsorizimet përfaqësojnë një instrument konkret financiar, i cili mbështetet nga kuadri ligjor ekzistues dhe krijon stimuj për përfshirjen e sektorit privat në financimin e aktiviteteve me interes publik. Ligji nr. 7892/1994 “Për sponsorizimet”, krijon stimuj konkretë fiskalë për korporatat që anagazhohen në financimin e aktiviteteve të SHKB-së.

Burime të tjera dhe CSR

Burime alternative financimi përfshijnë iniciativa të lidhura me misionin e organizatës, të tilla si organizimi i eventeve dhe konferencave, publikimet dhe produktet informative, si dhe pjesëmarrja në iniciativa dhe projekte rajonale. Një komponent me rëndësi të veçantë në këtë drejtim është Përgjegjësia Sociale Korporative (CSR) e cila përkufizohet si angazhimi vullnetar i bizneseve për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të shoqërisë, përtej objektivave të tyre të drejtpërdrejta ekonomike. Ky koncept është i konsoliduar në politikat dhe praktikatat e promovuara nga Komisioni Europian dhe OECD. Nga perspektiva e biznesit, angazhimi në iniciativa CSR sjell përfitime të rëndësishme, përfshirë përmirësimin e reputacionit publik, rritjen e besueshmërisë dhe pozicionimin si aktor kontribues në zhvillimin shoqëror dhe lokal.

9. Mbështetja qeveritare për organizatat europiane dhe reforma për Shqipërinë

Në vendet e Bashkimit Europian, mbështetja qeveritare është e institucionalizuar dhe përbën një instrument të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve të këtyre organizatave. Këto organizata luajnë një rol kyç në ndërmjetësimin ndërmjet autoriteteve publike dhe njësive vendore, duke kontribuar në përmirësimin e politikëbërjes dhe në përfaqësimin e interesave lokale.

Ndërsa në Shqipëri, ky dimension mbetet i pazhvilluar dhe kërkon ndërhyrje të strukturuar reformuese.

9.1 Modelet e mbështetjes qeveritare në Evropë

Në dallim nga kuadri ligjor në Shqipëri, në një numër të konsiderueshëm shtetesh europiane janë zhvilluar mekanizma të institucionalizuar të mbështetjes financiare për organizatat përfaqësuese të pushtetit vendor, si dhe për organizata të tjera që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve publike.

Këto mekanizma nuk kufizohen vetëm në financim të drejtpërdrejtë në kuptimin klasik, por përfshijnë një gamë instrumentesh, si grante publike, kontrata për ofrimin e shërbimeve, skema bashkëfinancimi dhe mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve institucionale. Kjo qasje është në përputhje me parimet e qeverisjes të promovuara nga OECD dhe Komisioni Europian.

Në këtë kontekst, përvoja ndërkombëtare demonstroi se organizatat përfaqësuese të njësive vendore financohen për shkak të rolit të tyre në:

- Përfaqësimin institucional të interesave lokale;
- Mbështetjen e proceseve të politikëbërjes;
- Zhvillimin e kapaciteteve administrative;
- Lehtësimin e koordinimit ndërmjet niveleve të qeverisjes.

Shembuj konkretë nga shtete europiane ilustrojnë këtë qasje:

- **Gjermania:** Shoqatat e pushtetit vendor dhe organizatat e trajnimit për administratën publike përfitojnë mbështetje financiare kryesisht nga niveli qendror i qeverisjes dhe nga niveli rajonal, në funksion të trajnimit, kërkimit dhe asistencës teknike për bashkitë.
- **Franca:** Shoqata “Association des Maires de France” përfiton mbështetje për aktivitete që lidhen me shërbimet publike, trajnimin dhe përfaqësimin institucional, shpesh nëpërmjet partneriteteve me shtetin.
- **Suedia dhe Belgjika:** Organizatat e pushtetit vendor dhe institucionet mbështetëse financohen për zhvillimin e kapaciteteve, kërkime dhe projekte pilot në fushën e qeverisjes publike.
- **Finlanda dhe Letonia:** Strukturat rajonale ndërbashkiake (councils of municipalities) financohen përmes një kombinimi të kontributeve të detyrueshme të bashkive dhe fondeve publike, duke përfshirë edhe fondet e Bashkimit Europian.
- **Austria dhe Portugalia:** Agjencitë e zhvillimit rajonal dhe strukturat ndërbashkiake mbështeten financiarisht nga autoritetet rajonale dhe fondet europiane, në kuadër të politikave të zhvillimit territorial.
- **Irlanda, Islanda dhe Bullgaria:** Modelet përfshijnë kombinime të kontributeve vendore me transferta shtetërore ose financim të drejtpërdrejtë për funksione të caktuara publike dhe zhvillim rajonal.
- **Mbretëria e Bashkuar (Wales):** Strukturat ndërbashkiake financohen përmes kontributeve të autoriteteve vendore dhe mekanizmave publikë që mundësojnë edhe gjenerimin e të ardhurave përmes tarifave dhe instrumenteve financiare.

Në tërësi, këto modele dëshmojnë se mbështetja qeveritare për organizatat përfaqësuese të pushtetit vendor është një praktikë e konsoliduar në Evropë, e cila synon të garantojë funksionimin efektiv të qeverisjes në të dyja nivelet dhe të forcojë kapacitetet institucionale në nivel lokal.

9.2 Kuadri aktual në Shqipëri dhe propozimi për reformim

Kuadri aktual ligjor në Shqipëri, i përcaktuar nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nuk parashikon mekanizma të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare për organizatat përfaqësuese të njësisë të vetëqeverisjes vendore, siç është SHKB. Mungesa e financimit të qëndrueshëm ndikon në dobësimin e kapaciteteve institucionale. OECD nënvizon se stabiliteti financiar i institucioneve ndërmjetëse është një faktor kyç për efektivitetin e qeverisjes dhe për koordinimin politikave publike. Gjithashtu, standardet e përcaktuara nga Këshilli I Europës, nëpërmjet “Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore”, theksojnë rëndësinë e garantimit të kushteve të përshtatshme institucionale dhe financiare për funksionimin efektiv të strukturave të vetëqeverisjes vendore dhe organizatave përfaqësuese të tyre.

Në kushte të tilla, reforma e propozuar synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar për mbështetjen financiare të organizatave përfaqësuese si SHKB, në përputhje me standardet europiane të qeverisjes.

9.3 Drejtimet e politikës dhe vlerësimi krahasues

Në një kohë kur Shqipëria po riorganizon ndarjen administrative-territoriale, sugjerohet paralelisht një paketë e integruar masash që ndërthur dimensionin ligjor, financiar dhe institucional, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian edhe për organizatat si SHKB. Identifikohen dy opsione kryesore që mund të jenë në fokus të reformës:

Alternativa e parë, që konsiston në një reformë të pjesshme, synon përmirësimin e mekanizmave ekzistues përmes rritjes së financimit projektual dhe forcimit të asistencës teknike. Ky opsion nuk kërkon ndryshime të thella ligjore dhe mbështetet në optimizimin e instrumenteve aktuale. Megjithatë, evidencat ndërkombëtare tregojnë se financimi i fragmentuar dhe i bazuar në projekte nuk garanton qëndrueshmëri institucionale (OECD, 2019). Për rrjedhojë, ndikimi i këtij opsioni mbetet i kufizuar në aspektin strukturor dhe afatgjatë.

Alternativa e dytë, i cili përfaqëson një reformë të plotë dhe konsiderohet si opsioni i preferuar, parashikon krijimin e një kuadri të ri ligjor dhe institucional që mundëson financimin e drejtpërdrejtë për organizata si SHKB. Ky opsion përfshin zhvillimin e skemave të strukturuar të financimit dhe ndërtimin e mekanizmave të fortë të monitorimit në përputhje me praktikën e vendeve të Bashkimit Europian, ku organizatat përfaqësuese të pushtetit vendor financohen përmes mekanizmave të institucionalizuar dhe të qëndrueshëm (European Commission, 2020).

Në planin institucional, reforma do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve organizative dhe profesionale, duke mundësuar një ofrim më cilësor dhe të strukturuar të shërbimeve ndaj anëtarëve.

Nga perspektiva e politikave publike, vendosja e një sistemi të qëndrueshëm financimi do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë dhe koherencës së ndërhyrjeve publike, si dhe në përmirësimin e procesit të hartimit dhe zbatimit të tyre. Njëkohësisht, mekanizmat e parashikuar të transparencës dhe llogaridhënies do të kontribuojnë në forcimin e besueshmërisë institucionale dhe në rritjen e besimit të publikut dhe aktorëve të interesit.

Në një dimension më të gjerë strategjik, kjo reformë përputhet me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Europian për zhvillimin e një administrate publike funksionale, të qëndrueshme dhe të orientuar drejt rezultateve, duke mbështetur procesin e integritet europian të vendit në përputhje me prioritetet e përcaktuara nga Komisioni Europian.

10. Konkluzione dhe Rekomandime

10.1 Konkluzione

Analiza e integruar e të dhënave sasiore dhe cilësore konfirmon se SHKB përfaqëson një strukturë kyçe në arkitekturën e qeverisjes vendore në Shqipëri, me një nivel të lartë legjitimiteti institucional dhe besimi nga bashkitë anëtare. Roli i saj si ndërmjetësuese ndërmjet nivelit vendor dhe atij qendror, si dhe si platformë për zhvillimin e kapaciteteve, e pozicionon atë si një aktor me rëndësi strategjike në funksionimin e sistemit të decentralizuar të qeverisjes. Megjithatë, studimi evidenton se qëndrueshmëria afatgjatë e organizatës ndikohet nga faktorë strukturorë, të cilët kërkojnë ndërhyrje të mirëstrukturuara dhe të koordinuara.

Transformimi i modelit financiar të SHKB-së, nuk është thjesht një nevojë organizative, por një domosdoshmëri strategjike për forcimin e decentralizimit dhe përmirësimin e qeverisjes vendore në Shqipëri. Një qasje e integruar, që lidh anëtarësimin, ofrimin e shërbimeve, strukturën e financimit dhe angazhimin institucional, krijon një cikël të qëndrueshëm zhvillimi, ku secili komponent përforcon tjetrin dhe gjeneron vlerë të shtuar për anëtarët dhe për sistemin e qeverisjes vendore.

- Modeli aktual financiar mbështetet në një kombinim burimesh, përfshirë kuotat e anëtarësimit dhe financimet nga donatorët ndërkombëtarë. Megjithatë në praktikë veçanërisht financimet e donatorëve, evidentohen si burime të paqëndrueshme. duke krijuar ekspozim të lartë ndaj riskut financiar dhe paqëndrueshmërisë së të ardhurave në afatgjatë.
- Ky konfigurim reflekton një devijim nga praktikat e konsoliduara ndërkombëtare. Në vendet e OECD-së, shoqatat e pushtetit vendor financohen përmes një modeli të kombinuar, ku kuotat e anëtarësimit përbëjnë bazën e qëndrueshme financiare, ndërsa mbështetja nga buxheti i shtetit dhe fondet konkurruese shërbejnë si instrumente plotësuese për forcimin e kapaciteteve dhe realizimin e funksioneve me interes publik. Ky model synon të balancojë autonominë institucionale me mbështetjen publike, duke garantuar qëndrueshmëri dhe efektivitet në afatgjatë.
- Sistemi uniform i kuotave nuk reflekton heterogjenitetin ekonomik, fiskal dhe institucional të bashkive, duke krijuar perceptime të mundshme të padrejtësisë dhe duke kufizuar potencialin për mobilizim optimal të të ardhurave
- Lidhja midis kontributit financiar dhe përfitimit nga shërbimet nuk është mjaftueshëm e strukturuar dhe e perceptueshme, duke ndikuar negativisht në motivimin për pagesë dhe në angazhimin aktiv të anëtarëve

- Kapacitetet për thithjen e fondeve, veçanërisht nga programet e Bashkimit Europian dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, mbeten të kufizuara, duke reduktuar mundësitë për diversifikim të burimeve financiare
- Kuadri ligjor aktual kufizon mundësinë e mbështetjes direkte financiare nga qeveria qendrore për shoqatat e pushtetit vendor, duke krijuar një boshllëk institucional në financimin e funksioneve me interes publik. Në këtë drejtim, praktikat e vendeve të OECD tregojnë se financimi publik për këto struktura është një komponent i zakonshëm dhe i nevojshëm për garantimin e qëndrueshmërisë dhe efektivitetit të tyre.

Nga ana tjetër, analiza evidenton një potencial të konsiderueshëm zhvillimi, i cili mund të shfrytëzohet përmes reformave të targetuara. Me konkretisht:

- Niveli i lartë i perceptimit pozitiv mbi SHKB (>90%) krijon një bazë të fortë besimi për ndërmarrjen e reformave strukturore
- Ekziston kërkesë reale për shërbime të avancuara dhe me pagesë, të qarta dhe të matshme.
- Praktikrat europiane dhe ndërkombëtare ofrojnë modele të konsoliduara për ndërtimin e një strukture të qëndrueshme financiare, të bazuar në kombinimin e burimeve publike dhe kontributeve të anëtarëve.

Në këtë kontekst, kombinimi i një modeli të ri të anëtarësimit me një strategji të diversifikuar të financimit përbën një ndërhyrje strukturore të domosdoshme për transformimin e SHKB-së, në një organizatë financiarisht të forte dhe të qëndrueshme, institucionalisht të konsoliduar dhe strategjikisht më efektive. Njëkohësisht, kjo qasje pritet të kontribuojë në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike në nivel vendor dhe në krijimin e ekonomive të shkallës përmes shërbimeve të përbashkëta.

10.2 Rekomandime strategjike dhe masa të zbatimit

Në përgjigje të sfidave strukturore të identifikuara në analizë dhe duke u mbështetur në potencialet ekzistuese të zhvillimit, rekomandimet e mëposhtme synojnë forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të SHKB-së. Këto rekomandime janë të bazuara në evidencë empirike dhe në praktikrat ndërkombëtare të qeverisjes vendore dhe menaxhimit të organizatave përfaqësuese, të promovuara, ndër të tjera, nga OECD dhe literatura bashkëkohore mbi decentralizimin dhe qeverisjen në të dyja nivelet. Qasja e ndjekur kombinon ndërhyrjet strukturore me masa operacionale të zbatueshme në afate të diferencuara kohore.

1. Reformimi i modelit të anëtarësimit:

Masa:

- Miratimi i një modeli të diferencuar të kuotave, bazuar në madhësinë, kapacitetin fiskal dhe karakteristikat socio-ekonomike të bashkive
- Përcaktimi i paketave të strukturuara të përfitimeve (bazë, standard, premium), të lidhura drejtpërdrejt me nivelin e kontributit
- Vendosja e mekanizmave stimulues, si zbritjet për pagesë të hershme dhe përfitimet shtesë në formën e shërbimeve

Afati: 6-12 muaj

Indikator suksesi: $\geq 85\%$ e kuotave të mbledhura brenda vitit të parë

2. Zhvillimi i kapaciteteve dhe diversifikimi i burimeve financiare

Masa:

- Hartimi i katalogut të shërbimeve dhe paketave të diferencuara për anëtarët dhe qeverisjen vendore, duke përfshirë certifikime, kredite profesionale dhe mbështetje në integrimin europian, zhvillimin territorial dhe fusha të tjera kyçe
- Krijimi i **Project Development Unit** dhe trajnime të specializuara për fondet e Bashkimit Europian
- Krijimi i paketave sponsorizimi për sektorin privat, aktivizimi i skemave CSR dhe organizimi i eventeve financuese

Afati: 6–18 muaj (varësisht nga lloji i masës)

Indikator suksesi:

- $\geq 30\%$ rritje e përdorimit të shërbimeve nga anëtarët
- $\geq 2-3$ projekte të reja të fituara në fonde ndërkombëtare/vit
- $\geq 20\%$ e të ardhurave nga burime alternative

3. Reforma ligjore dhe mbështetja institucionale

Masa:

- Hartimi i draft-ndryshimeve ligjore
- Realizimi i lobimit institucional me ministritë dhe Kuvendin
- Pilotimi i skemave të financimit të drejtpërdrejtë për anëtarët

Afati: 12–24 muaj

Indikator suksesi: miratimi i një mekanizmi pilot financimi

4. Sistemi i monitorimit dhe performancës (M&E)

Masa:

- Përforcimi i indikatorëve kyç të performancës (KPI) financiarë dhe operacionale
- Standardizimi dhe publikimi i raporteve tremujore dhe vjetore për monitorimin e progresit
- Vazhdimi i auditimeve të rregullta dhe publikimi i rezultateve për të garantuar transparencën dhe efikasitetin

Afati: 0–6 muaj (implementim fillestar)

Indikator suksesi: publikim sistematik i raporteve

11. Aneks

Ne Aneks paraqiten pyetesoret dhe intervistat gjysme te strukturuara Pyetëtori i hartuar iu shpërnda njësisë të qeverisjes vendore (NJQV) nëpërmjet platformës Google Forms, duke synuar mbledhjen e informacionit nga të gjitha bashkitë, mbi kapacitetet aktuale, sfidat dhe nevojat prioritare në lidhje me modelin e anëtarësimit dhe strategjinë e mbledhjes së fondeve. Pyetëtori iu pergjigjen 165 specialiste dhe drejtues te bashkive. Per të verifikuar dhe thelluar gjetjet e dala nga pyetëtorët, ne kuader te ketij studimi, gjithashtu u realizuan intervista gjysmë të strukturuara përmes platformës Zoom. Intervistat u zhvilluan me përfaqësues në nivel drejtues të bashkive si më poshtë:

- Bashkia Berat
- Bashkia Elbasan
- Bashkia Pogradec
- Bashkia Vlorë

11.1. Pyetëtori për Bashkitë: Strategjia e mbledhjes së fondeve dhe Modeli i Ri i anëtarësimit

Ju lutemi të plotësoni pyetëtorin duke shënuar përgjigjet që përputhen më mirë me situatën e bashkisë tuaj. Theksojmë se modeli aktual i kuotave të anëtarësisë dhe formula e llogaritjes janë të miratuara me vendim të Asamblesë së SHKB-së. Por pyetëtori dhe rezultatet e tij do të përdoren për përmirësimin e modelit të anëtarësimit dhe shërbimeve institucionale, në vitet e ardhshme.

Emri i bashkisë: _____

Popullsia:

- Deri në – 10,000 banorë
- 10,001 – 50,000 banorë
- 50,001 – 100,000 banorë
- 100,001 – 250,000 banorë
- Mbi –250,000 banorë

Si e vlerëson bashkia rolin përfaqësues të SHKB-së?

- Shumë i dobishëm
- Mjaftueshëm
- Pak i dobishëm
- Jo i dobishëm

Sa ndikim ka SHKB në zhvillimin dhe mbështetjen e pushtetit vendor?

- Shumë
- I konsiderueshëm
- I kufizuar
- I vogël

Cilat shërbime të SHKB-së përdoren më shpesh nga bashkia? (Shënoni të gjitha që vlejné)

- Trajnime dhe zhvillim kapacitetesh
- Asistencë teknike dhe konsulencë
- Publikime dhe analiza
- Evente dhe konferenca
- Të tjera: _____

Si e vlerësoni cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara?

- Shumë e mirë
- E mirë
- Mesatare
- Dobët

Çfarë nivelesh kuotash janë të preferuara për bashkinë tuaj?

- Kuota fikse vjetore
- Kuota të bazuara në madhësinë e bashkisë
- Kuota të bazuara në shërbimet e përdorura
- Të tjera: _____

Cilat kategori anëtarësimi konsideroni më të përshtatshme?

- Anëtar bazik(kuotë më e ulët, shërbime bazë)
- Anëtar standard(kuotë mesatare, shërbime më të zgjeruara)
- Anëtar premium(kuotë më e lartë, të gjitha shërbimet dhe avantazhet)

Si duhet të strukturohen kuotat?

- Sipas madhësisë së bashkisë
- Sipas kapaciteteve financiare
- Sipas nivelit të angazhimit dhe përdorimit të shërbimeve
- Sipas popullsisë

Cilat shërbime me pagesë janë më të nevojshme për bashkitë? (Shënoni të gjitha që vlejné)

- Trajnime specializuese
- Asistencë teknike individuale
- Produkte analitike dhe raporte
- Konsulencë ligjore dhe administrative
- Të tjera: _____

Sa e gatshme është bashkia të paguajë për shërbime të caktuara?

- Shumë e gatshme
- E gatshme
- Pak e gatshme
- Jo e gatshme

Cilat janë pritshmëritë për raportimin financiar dhe transparencën e SHKB-së? (Shënoni të gjitha që vlejné)

- Raport i përgjithshëm vjetor
- Raport i përmbledhur me informacion kryesor
- Raportime periodike gjatë vitit
- Të tjera: _____

Cilat aktivitete do të ishin më të dobishme për të përfituar nga donatorët?

- Trajnime për stafin e bashkisë

- Projekte sociale, edukative, kulturore
- Evente dhe konferenca
- Publikime dhe analiza
- Të tjera: _____

11.2. Intervistat per modelin e ri dhe strategjine e fondeve

Tema: Strategjia e Mbledhjes së Fondeve dhe Modeli i Ri i Anëtarësimit për SHKB-në

Kjo guidë interviste është hartuar për të mbledhur të dhëna cilësore mbi perceptimet e përfaqësuesve të bashkive lidhur me rolin, shërbimet dhe potencialin e zhvillimit financiar të SHKB-së. Pyetjet e hapura dhe synuan të nxisin diskutim të thelluar dhe reflektim mbi përvojat konkrete.

Seksioni 1: Roli dhe përfaqësimi institucional

1. Si e vlerësoni rolin e SHKB-së në përfaqësimin e interesave të bashkisë suaj në nivel kombëtar?
2. Në cilat fusha mendoni se SHKB ka arritur të ndikojë më shumë në mbështetjen e pushtetit vendor?
3. Mund të ndani një shembull konkret ku bashkia juaj ka përfituar nga ndërhyrja ose advokimi i SHKB-së?

Seksioni 2: Vlerësimi i shërbimeve

4. Si e vlerësoni ndikimin e trajnimeve dhe asistencës teknike të ofruara nga SHKB-ja në zhvillimin e kapaciteteve të stafit të bashkisë suaj?
5. Cilat shërbime të ofruara nga SHKB-ja i konsideroni më të vlefshme për bashkinë tuaj?

Seksioni 3: Shërbimet me pagesë dhe modeli financiar

6. A mendoni se disa shërbime të specializuara të SHKB-së mund të ofrohen kundrejt pagesës? Nëse po, cilat do të ishin më të përshtatshme?
7. Cilat shërbime do të kishin vlerë për bashkinë tuaj edhe nëse do të kërkonin një kontribut financiar specifik?

Seksioni 4: Modeli i anëtarësimit

8. Si e vlerësoni mundësinë e një sistemi të diferencuar të kuotave të anëtarësimit sipas madhësisë ose kapacitetit

12. Referencat

National Association of Municipalities of Albania (SHKB). (2026–2030). *Strategic Plan 2026–2030* [Internal report].

OECD. (2019). *Making Decentralisation Work: A Handbook for Policy-Makers*. Paris: OECD Publishing.

OECD. (2022). *Fiscal Federalism 2022: Funding and Financing of Local Government Public Investment*. Paris: OECD Publishing.

OECD. (2022). *Regional Governance in OECD Countries*. Retrieved from https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2022/12/regional-governance-in-oecd-countries_a9c03edb/4d7c6483-en.pdf?utm_source=chatgpt.com

Council of Europe. (1985). *European Charter of Local Self-Government*. Strasbourg: Council of Europe.

OECD & United Cities and Local Governments (UCLG). *Subnational Finance and Investment*. OECD-UCLG.